



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.16

1 mars

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.58, datë 29.1.2010

Për miratimin e projekteve emergjente për njësitë e qeverisjes vendore të qarqeve të Shkodrës e të Lezhës dhe të fondeve shtesë për ministritë e linjës, për riaftësimin e infrastrukturës së dëmtuar e të objekteve sociale e publike, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet..... 501

Udhëzim i përbashkët i MPJ,
MB, MPCSSH, SHISH
nr.408/2, datë 11.2.2010

Mbi ngritjen dhe funksionimin e regjistrit elektronik kombëtar për të huajt..... 503

VENDIM
Nr.58, datë 29.1.2010

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTEVE EMERGJENTE PËR NJËSITË E QEVERISJES
VENDORE TË QARQEVE TË SHKODRËS E TË LEZHËS DHE TË FONDEVE SHITESË
PËR MINISTRITË E LINJËS, PËR RIAFTËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SË DËMTUAR
E TË OBJEKTEVE SOCIALE E PUBLIKE, NGA RESHJET E SHIUT DHE PËRMBYTJET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 7 e 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projekteve emergjente për njësitë e qeverisjes vendore të qarqeve të Shkodrës e të Lezhës dhe të fondeve shitesë në buxhetin e vitit 2010 për ministrinë e linjës, për riaftësimin e infrastrukturës së dëmtuar e të objekteve sociale dhe publike, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit t’i shtohet fondi 113 105 120 (njëqind e trembëdhjetë milionë e njëqind e pesë mijë e njëqind e njëzet) lekë, për projektet sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit t’i shtohet fondi 50 569 180 (pesëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë, për projektet sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 163 674 300 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind) lekë, të përballohen, si më poshtë vijon:

a) 66 195 000 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë nga fondi i emergjencave civile të këshillit të qarkut të Shkodrës;

b) 97 279 300 (nëntëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind) lekë nga donacionet monetare, të mbledhura në llogaritë bankare të hapura për këtë qëllim, të përcaktuara në vendimin nr.2, datë 9.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e mënyrën e përdorimit të fondit të emergjencave civile në qarkun e Shkodrës, për të përballuar situatën e shkaktuar nga përmbytjet natyre”.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr.	Emërtimi i objektit ose punimeve të kryera	Vlera në lekë
A.	Qarku Shkodër	
1.	Thellimi i grykëderdhjes së lumit Buna me dragë	35 348 299
2.	Shpenzime të kryera për mbrojtjen e argjinaturave në komunën Velipojë, qarku Shkodër	3 500 000
3.	Shpenzime të kryera për mbrojtjen e argjinaturave në komunën Dajç, qarku Shkodër	2 425 000
4.	Shpenzime të kryera për mbrojtjen e argjinaturave në komunën Bushat, qarku Shkodër	1 000 000
5.	Shpenzime të kryera për mbrojtjen e argjinaturave në komunën Guri i Zi, qarku Shkodër	60 000
	Totali 1	41 748 299
B.	Qarku Lezhë	
6.	Shpenzime të kryera në hidrovorin e Tales, qarku Lezhë	7 737 398
7.	Shpenzime të kryera në argjinaturën e Ishull-Shëngjin, qarku Lezhë	9 269 751
8.	Blerje gurësh për argjinaturat, qarku Lezhë	2 049 672
9.	Shpenzime punimesh me ekskavator për argjinaturat, qarku Lezhë	2 300 000
	Totali 2	21 356 821
10.	Blerje koncentrate dhe ushqime për blegtorinë	49 415 000
	TOTALI	113 105 120

Lidhja nr.2

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

Nr.	Emërtimi i objektit ose punimeve të kryera	Vlera në lekë
A.	Qarku Shkodër	
1	Prishja e Urës së Vjetër së Gjolulit	242 000
2	Rikonstruksioni i argjinaturës dhe bashkimit me urën e Spatharit (rruga Shkodër-Mjedë)	3 600 000
3	Rikonstruksioni i argjinaturës së Bisht Juk-Ura e Gjolulit	6 040 000
4	Rikonstruksioni i Urës së Bunës (seksioni ura e Bunës, Muriqan-Shirokë)	3 600 000
5	Ndërtimi i linjës lidhëse të furnizimit me ujë për dy depot e ujit në stacionin e Dobraçit për njësinë klorinuese	5 185 180
6	Lidhja me kanalizime të ujërave të përdorura në Dobraç	4 158 000
7	Instalimi i njësisë së automatizuar për disinfektimin e ujit në stacionin e depozitave në Dobraç	728 000
8	Makineri dhe pajisje	6 216 000
9	Shpenzime punimi për avolxhime (elektromotorë, transformatorë, blerje klori), sh.a. ujësjellës-kanalizime, Vau i Dejës	800 000
B.	Qarku Lezhë	
10	Shpenzime për avolxhime elektromotorë dhe për blerje klori, sh.a. ujësjellës-kanalizime, Lezhë	800 000
C.	Qarku Kukës	
11	Mbrojtja Ura e Drinit, Fierzë	4 000 000
12	Masa inxhinierike Qafë-Mali, Fierzë	15 000 000
	TOTALI	50 569 180

UDHËZIM
Nr.408/2, datë 11.2.2010

MBI NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT ELEKTRONIK KOMBËTAR
PËR TË HUAJT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të neneve 99, 100 dhe 101 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.362, datë 1.4.2009 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, vendimeve të Këshillit të Ministrave nga nr.348 deri në nr.360, datë 6.3.2009 për lejet e punës,

UDHËZOJMË:

I. MODULET PËRBËRËSE TË REGJISTRIT ELEKTRONIK KOMBËTAR PËR TË HUAJT

1. Regjistri elektronik kombëtar për të huaj është një bazë të dhënash elektronike, në të cilën hidhet dhe ruhet aktiviteti i strukturave shtetërore të ngarkuara me ligj, lidhur me trajtimin e të huajve që kërkojnë të hyjnë, qëndrojnë, punojnë, tranzitojnë dhe dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë.

2. Regjistri elektronik kombëtar për të huajt bën të mundur që autoritetet e përcaktuara në këtë udhëzim, të hedhin informacionin mbi të huajt sipas fushave të përgjegjësive të përcaktuara me ligjin nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt” dhe procedurave të miratuara me këtë udhëzim apo procedurave të brendshme ekzistuese të miratuara më parë për modulet ekzistuese, pjesë përbërëse të regjistrit, si dhe me anë të një procedure kërkimi të automatizuar, mundëson qasje në konsultimin e këtyre të dhënave për interes të punës së tyre, të alarmeve për persona, për qëllime të kontroleve kufitare dhe kontroleve të tjera policore, për qëllime të dhënies së vizave, azilit, lejeve të qëndrimit, lejeve të punës dhe administrimit të legjislacionit për të huajt në kontekstin e zbatimit të dispozitave në lidhje me trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë. Çdo e dhënë e hedhur në regjister, prej secilës strukturë të përcaktuar me këtë udhëzim, vihet në dispozicion për qëllime të kryerjes së kërkimeve të automatizuara për të gjitha strukturat e tjera të përcaktuara po në këtë udhëzim.

3. Regjistri elektronik kombëtar për të huajt përbëhet nga këto module:

1. Moduli i kontrollit kufitar;

2. Moduli i E-viza;

3. Moduli i E-leje qëndrimi;

4. Moduli i E-leje pune;

5. Moduli i trajtimit të të huajve të parregullt në kufi dhe në territor.

4. Regjistri elektronik kombëtar për të huaj funksionon si pjesë e sistemit TIMS në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, me të gjitha modulet e përshkruara në këtë udhëzimi, deri sa institucionet e tjera përgjegjëse të krijojnë sistemet e tyre me njërin apo disa nga modulet e sipërpërmendura. Me krijimin e këtyre sistemeve, regjistri për të huaj funksionon mbi bazën e këmbimit dhe replikimit të informacionit *on line* ndërmjet këtyre sistemeve.

5. Drejtoria e Teknologjisë dhe Menaxhimit të Informacionit është autoriteti kompetent për zhvillimin e regjistrit kombëtar për të huajt, si dhe përqendrimin, administrimin dhe menaxhimin e të dhënave të këtij regjistri.

6. Struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit u jep të drejtat përdoruesve në regjistrin kombëtar për të huajt, në modulet përkatëse, si dhe klasifikon nivelet e përdorimit të sistemit, bazuar në urdhrat dhe udhëzimet e kësaj strukture, në ligjin për mbrojtjen e të dhënave, si dhe në këtë udhëzim.

7. Struktura informatike e ruajtjes së të dhënave, platforma e aplikacionit, si dhe vetë aplikacioni janë subjekt i ndryshimeve të mëvonshme, për qëllime mirëmbajtjeje, përmirësimi, shtime të moduleve të tjera lehtësuese apo funksionaliteteve të reja, të cilat nuk prekin integritetin e të dhënave dhe kanë pjesë të tyre të gjitha modulet e përmendura më lart.

8. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në DPP, në Ministrinë e Brendshme, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe shërbimi i teknologjisë së informacionit në Shërbimin Informativ Shtetëror, marrin masa për të përshtatur teknologjinë e informacionit sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

9. Kostot e krijimit të moduleve të regjistrimit dhe të funksionit në sistemin TIMS përballohen nga administratori i sistemit TIMS. Kostot e instalimit, trajnimit dhe kompletimit të logjistikës së nevojshme, në interes të funksionimit të këtij regjistri, përballohen nga institucionet sipas nevojave të tyre. Kostot e krijimit të bankave të reja të të dhënave jashtë sistemit TIMS dhe lidhjes së tyre me regjistrin mbulojnë nga institucionet që i krijojnë ato.

10. Sistemi automatikisht identifikon përdoruesin, kohën e regjistrimit dhe konsultimit të çdo informacioni që përmban sistemi.

11. Sistemi gjithashtu është në gjendje të raportojë mbi statistika dhe raportime të ndryshme për çdo modul sipas nevojave të përdoruesit dhe përcaktimeve në këtë udhëzim.

II. INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË REGJISTRIMIN DHE KONSULTIMIN E TË DHËNAVE NË REGJISTËR

1. Autoritetet kompetente që hedhin të dhëna në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt janë:

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme:

- Sektori i vizë-pasaportave në Drejtorinë Konsullore;
- Përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore jashtë shtetit;

Në Ministrinë e Brendshme:

- Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët;
- Sektori i migracionit në Drejtorinë e Migracionit dhe Ripranimeve;
- Sektori i ripranimeve në Drejtorinë e Migracionit dhe Ripranimeve.
- Sektorët e migracionit në drejtoritë rajonale për kufirin dhe migracionin;
- Shërbimet e policisë kufitare dhe migracionit në pikat e kalimit kufitar;
- Shërbimet e pritjes në Qendrën e mbyllur për të huajt me qëndrim të parregullt në territor;
- Sektori i menaxhimit të informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave në Drejtorinë e Qendrës së Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

- Sektori i imigrimit në Drejtorinë e Politikave Migratore, Kthimit dhe Riintegritimit;
- Sektori i marrëdhënieve të punës dhe migrimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit

Kombëtar të Punësimit;

- Sektorët e migracionit dhe marrëdhënieve të punës në drejtoritë rajonale të punësimit;
- Zyrat vendore të punësimit;
- Drejtoritë rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës.

Në Shërbimin Informativ Shtetëror:

- Struktura përgjegjëse për vlerësimin e kërkesave për vizë.

2. Autoritetet kompetente që konsultojnë të dhënat në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt janë:

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme:

- Drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Ndërkombëtare dhe Konsullore;
- Drejtori i Drejtorisë Konsullore;
- Sektori i vizë-pasaportave në Drejtorinë Konsullore;
- Përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore jashtë shtetit.

Në Ministrinë e Brendshme:

- Drejtori për Shtetësinë dhe Refugjatët;
- Zëvendës-drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për Kufirin dhe Migracionin në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Drejtori i Migracionit dhe Ripranimeve në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin;
- Sektori i migracionit në Drejtorinë e Migracionit dhe Ripranimeve;
- Sektori i ripranimeve në Drejtorinë e Migracionit dhe Ripranimeve;

- Zyra e analizës së rrezikut në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin;
- Sektorët e migracionit në drejtoritë rajonale për kufirin dhe migracionin;
- Shërbimet e policisë kufitare dhe të migracionit në pikat e kalimit kufitar;
- Drejtori, shërbimet e pritjes dhe shërbimet e intervistimit të Qendrës së mbyllur për të huajt me qëndrim të parregullt në territor;

- Sallat operative në nivel rajonal dhe ajo në nivel qendror.

Në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

- Drejtoria e Politikave Migratore, Kthimit dhe Riintegritimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës;
- Drejtoritë rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
- Sektorët e migracionit dhe marrëdhënieve të punës në drejtoritë rajonale të punësimit;
- Zyrat vendore të punësimit.

Në Shërbimin Informativ Shtetëror:

- Struktura përgjegjëse për vlerësimin e kërkesave për vizë.

3. Brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, secili nga autoritetet e sipërpërmendura mbledh, regjistron, administron dhe konsulton të dhënat për të huajt, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.362, datë 1.4.2009, 12 vendimet e Këshillit të Ministrave, nga nr.348 deri në nr.359, datë 6.3.2009 për lejet e punës, udhëzimi i përbashkët nr.1102/4, datë 3.8.2009 “Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt”, udhëzimi i përbashkët nr.2947/2, datë 6.10.2009 “Mbi procedurat e trajtimit të të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë” dhe në këtë udhëzim.

4. Sektori i menaxhimit të informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave në Drejtorinë e Qendrës së Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit hedh të dhënat sipas kërkesave në rrugë shkresore të drejtuara nga strukturat e përcaktuara me këtë udhëzim, si dhe akteve të tjera të dala për funksionimin e Qendrës së Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave.

5. Përdoruesit mund të kërkojnë dhe konsultojnë vetëm të dhëna që u duhen për kryerjen e detyrave të tyre. Keqpërdorimi i këtyre të dhënave, si dhe informimi i personave të paautorizuar mbi përmbajtjen e tyre dënohet sipas dispozitave ligjore në fuqi mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Institucionet e lartpërmendura duhet të dërgojnë pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, listën e autoriteteve kompetente të cilat kërkojnë të autorizohen të hedhin dhe konsultojnë të dhënat në regjistër. Për çdo autoritet në listë specifikohet fusha e aksesit që kërkohet të autorizohet në hedhjen apo konsultimin e të dhënave. Listat mund të jenë objekt përditësimi, veprim i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas kërkesave të institucioneve përgjegjëse të përcaktuara në këtë udhëzim.

7. Vetëm struktura që hedh të dhënat do të jetë e autorizuar për të modifikuar, për të shtuar, korrigjuar ose fshirë të dhënat që ajo ka regjistruar.

8. Nëse një nga strukturat e përcaktuara në këtë udhëzim, e cila nuk e ka hedhur të dhënën, por duke i konsultuar ato, ka prova që sugjerojnë se një pjesë e të dhënave është faktikisht e pasaktë apo është ruajtur në mënyrë të paligjshme, atëherë ajo këshillon strukturën përgjegjëse që i ka hedhur këto të dhëna sa më shpejt të jetë e mundur mbi këtë fakt dhe kjo e fundit është e detyruar të kontrollojë të dhënën e hedhur dhe nëse është e nevojshme, korrigjon ose fshin të dhënat e pasakta apo të ruajtura në mënyrë të paligjshme.

III. MODULI E-VIZA

PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË VIZAVE NË MODULI NGA PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE DHE POSTET KONSULLORE JASHTË SHTETIT

1. Autoritetet shtetërore kompetente për lëshimin e vizave në Ministrinë e Punëve të Jashtme (përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore jashtë shtetit), pasi kryejnë procedurat e pranimit të kërkesës për pajisje me vizë të të huajt, hedhin informacionin mbi aplikimin në modul E-viza të regjistrit elektronik kombëtar për të huajt.

2. Në rast se në momentin e regjistrimit *on line* të aplikimit për vizë, në bazën e të dhënave të njërit nga modulet e regjistrimit ekziston informacion me masa kufizuese për kërkuesin e vizës që i ndalojnë hyrjen në Republikën e Shqipërisë, moduli i E-vizës mundëson regjistrimin e aplikimit, por në mënyrë të automatizuar nuk lejon vazhdimin e procedurës së mëtejshme të dërgimit të aplikimit për vlerësim, kështu që vendimi për refuzimin e vizës merret menjëherë nga punonjësi konsullor, veprim i cili pasqyrohet në regjistër.

3. Në rast se për kërkuesin e vizës nuk ka informacion kufizues në modulet e regjistrimit, punonjësit në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore jashtë shtetit janë të detyruar të regjistrojnë të gjithë informacionin sipas rubrikave të përgatitura në formë elektronike në modulën E-viza dhe të përcaktuara me anë të rregullores së përdorimit të modulit E-viza të përgatitura nga krijuesi i modulit. Mosplotësimi i të gjitha rubrikave të këtij regjistri konsiderohet informacion i pamjaftueshëm për pajisjen e aplikuesit me vizë.

4. Me përfundimin e regjistrimit të saktë të të dhënave të aplikimit për vizë dhe ruajtjes në sistem, këto të dhëna dërgohen për miratim në Drejtorinë Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila, pasi i konsulton paraprakisht, i dërgon për verifikim sipas udhëzimit nr.9486/1, datë 11.8.2009 “Për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt”.

5. Në rast se shënimi i strukturave të Drejtorisë së Migracionit dhe atij të Shërbimit Informativ Kombëtar në rubrikat përkatëse është në favor të lëshimit të vizës, atëherë Drejtoria Konsullore bën shënimin e gjykuar prej tij në rubrikën përkatëse në regjistër. Në rast se vendimi i Drejtorisë Konsullore është në favor të lëshimit të vizës, atëherë ky vlen si autorizim për lëshimin e vizës për postin konsullor që ka pranuar aplikimin dhe vetëm ky veprim në mënyrë të automatizuar i mundëson postin konsullor të vazhdojë procedurën për lëshimin e vizës.

6. Në rast se njëra nga dy strukturat e përfshira në procedurën e vlerësimit të aplikimit për vizë, brenda 7 ditëve nuk ka kthyer përgjigje mbi vlerësimin e aplikimit për vizë, por bën shënimin në rubrikën përkatëse të regjistrimit se kërkon shtyrjen e afatit për vlerësimin e kërkesës, atëherë procedura e vlerësimit mbetet në mënyrë të automatizuar në pritje deri në 7 ditë të tjera.

7. Në rast se njëra nga dy strukturat e përfshira në procedurën e vlerësimit të aplikimit për vizë, brenda afatit të shtyrë për vlerësimin e vizës, bën shënimin në rubrikën përkatëse të regjistrimit se kërkon rishtyrjen e afatit për vlerësimin e kërkesës, atëherë procedura e vlerësimit mbetet në mënyrë të automatizuar në pritje edhe deri në 7 ditë të tjera.

8. Në rast se asnjëra nga dy strukturat e përfshira në procedurën e vlerësimit të aplikimit për vizë nuk kthen përgjigje brenda afatit të përcaktuar ose nuk bën shënimet në rubrikat përkatëse se kërkon shtyrjen e afatit apo rishtyrjen e afatit për vlerësimin e kërkesës për vizë, ose kur dhe këto afate kanë kaluar dhe strukturat e sipërcituara nuk kanë kthyer përgjigje, kërkesa e konsideruar e miratuar mundëson që në mënyrë të automatizuar në sektorin e vizë-pasaportave në Ministrinë e Punëve të Jashtme të vazhdohet procedura e lëshimit të vizës.

9. Në rast se njëra nga dy strukturat e përfshira në procedurën e vlerësimit të aplikimit për vizë në afatet e caktuara, të shtyra apo të rishtyra, bën shënimin në rubrikat se nuk është dakord për miratimin e lëshimit të vizës, shoqëruar kjo dhe me argumentimin ligjor, atëherë procedura e vlerësimit të vizës ndërpritet dhe Drejtoria Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme është struktura e cila merr vendimin e refuzimit të kërkesës për lëshimin e vizës. Ky informacion konsultohet nga të gjitha postet konsullore në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit.

10. Me lëshimin e vizës nga nëpunësi në postin konsullor apo përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit, të dhënat e vizës së lëshuar janë të pandryshueshme dhe mund të konsultohen *on line* nga autoritete kompetente që konsultojnë të dhënat në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt të përmendura në pikën 2 kapitulli II, të këtij udhëzimi si më poshtë:

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme:

- Drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Ndërkombëtare dhe Konsullore;
- Drejtori i Drejtorisë Konsullore;
- Sektori i vizë-pasaportave në Drejtorinë Konsullore.

Në Ministrinë e Brendshme:

- Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

- Drejtori i Migracionit dhe Ripranimeve në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin;
- Sektori i migracionit në Drejtorinë e Migracionit dhe Ripranimeve;
- Sektori i ripranimeve në Drejtorinë e Migracionit dhe Ripranimeve;
- Sektorët e migracionit në drejtoritë rajonale për kufirin dhe migracionin;
- Shërbimet e policisë kufitare dhe migracionit në pikat e kalimit kufitar;
- Sallat operative në nivel rajonal dhe ajo në nivel qendror.

Në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

- Drejtoria e Politikave Migratore, Kthimit dhe Riintegritimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
- Sektorët e migracionit dhe marrëdhënieve të punës në drejtoritë rajonale të punësimit;
- Zyrat vendore të punësimit.
- Në Shërbimin Informativ Shtetëror:
- Struktura përgjegjëse për vlerësimin e kërkesave për vizë.

11. Në rastet e anulimit dhe/ose bërjes së pavlefshme të vizës së lëshuar nga përfaqësitë diplomatike apo postet konsullore jashtë shtetit apo vizës së kërkuar për t'u lëshuar në kufi nga autoriteti shtetëror përgjegjës në Ministrinë e Punëve të Jashtme, pas kryerjes së procedurave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët për bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror “Për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt”, informacioni mbi vendimin për anulimin dhe bërjen të pavlefshme të vizës hidhet menjëherë në regjistrin kombëtar për të huajt, modulën E-viza, nga autoriteti shtetëror përgjegjës në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ky informacion mund të konsultohet *on line* nga të gjitha autoritetet kompetente që konsultojnë të dhënat në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt të përmendura në pikën 2, kapitulli II, të këtij udhëzimi. Autoriteti i cili ekzekuton anulimin dhe bërjen e pavlefshme të vizës hedh gjithashtu në modulën E-viza informacionin me veprimet e kryera, informacioni i cili konsultohet nga të njëjtat autoritete si më sipër.

12. Pas përfundimit të afateve të vizës së lëshuar (afatit të përdorimit apo afatit të shfrytëzimit), në rast se shtetasi i huaj ndodhet në territor, sistemi duke u konsultuar në mënyrë të automatizuar me të dhënat e vizës dhe ato të regjistrimit të hyrje-daljeve gjenerojnë një “alarm-alert” në formën e një raporti me shtetasit të cilëve u ka përfunduar viza, listë e cila konsultohet nga autoritetet e Policisë Kufitare dhe Migracionit të ngarkuara me kontrollin e të huajve në territor dhe të përmendura në këtë udhëzim, si dhe në pikat e kalimit kufitar kur i huaji paraqitet për të dalë nga Republika e Shqipërisë.

13. Në rast se shtetasi i huaj të cilit i kanë përfunduar afatet e vizës së lëshuar (afatit të përdorimit dhe afatit të shfrytëzimit) ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe paraqitet në njërin nga PKK-të për të hyrë në territor, sistemi në mënyrë të automatizuar bën përllogaritjen e këtyre afateve dhe nuk mundëson regjistrimin e hyrjes për këtë shtetas.

14. Moduli E-viza, si pjesë e regjistrit kombëtar për të huajt, gjeneron raporte dhe statistika për afate të caktuara, sipas të dhënave që ka hedhur secila strukturë në këtë modul, si më poshtë:

Për Ministrinë e Punëve të Jashtme:

1. Numrin e vizave të dhëna, të ndara sipas:

- tipit,
- motivit,
- afatit,
- shtetësive,
- autoriteteve lëshuese dhe posteve konsullore,
- grupmoshave,
- gjinive.

2. Numrin e kërkesave për vizë të refuzuara:

Nga postet konsullore, sipas:

- arsyes së refuzimit;
- postit konsullor që ka bërë refuzimin;
- shtetësive të të refuzuarve;
- grupmoshave;

- gjinive.

Nga Drejtoria Konsullore, sipas:

- arsyes së refuzimit;
- strukturës që ka propozuar refuzimin;
- shtetësisë së të refuzuarve;
- grupmoshave;
- gjinive.

3. Numrin e vizave të anuluar sipas:

- motivit;
- shtetësive;
- grupmoshave;
- gjinive;
- autoritetit që ka lëshuar vizat;
- vendit ku është bërë anulimi i vizës;
- tipit të vizës së anuluar;
- autoriteti që ekzekuton anulimin e vizës.

Për Ministrinë e Brendshme:

1. Numrin e vizave të dhëna në kufi, të ndara sipas:

- tipit,
- motivit,
- afatit,
- shtetësive,
- autoriteteve që kanë autorizuar lëshimin e vizës,
- grupmoshave,
- gjinive.

2. Numrin e kërkesave për vizë të verifikuar dhe miratuar, sipas:

- tipit,
- motivit,
- shtetësive,
- posteve konsullore ku është bërë aplikimi,
- grupmoshave,
- gjinive.

3. Numrin e kërkesave për vizë të verifikuar dhe refuzuara, sipas:

- tipit;
- motivit;
- shtetësive;
- arsyes së refuzimit, sipas:
 - mosplotësimi të kushteve ligjore të kërkuarit të vizës;
 - mosplotësimi të kushteve nga ftuesi;
 - masave kufizuese ose ndaluese ndaj të huajt që kërkon vizë;
 - të dhënave për implikim në trafik ose kontrabandim të qenieve njerëzore;
 - posteve konsullore ku është bërë aplikimi;
- grupmoshave;
- gjinive.

IV. MODULI E-VIZA

PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË VIZËS SË LËSHUAR NË PKK

1. Autoriteti kompetent për lëshimin e vizave në PKK është përgjegjësi i turnit në PKK.

2. Pas paraqitjes së shtetasit të huaj në pikën e kalimit kufitar dhe pas përfundimit të procedurave për lëshimin e vizës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.362, datë 1.4.2009 dhe udhëzimit e përbashkët për bashkëpunimin mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror “Për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt”, në rubrikën përkatëse të modulit E-viza bëhet regjistrimi i informacionit mbi vizën e lëshuar.

3. Viza e lëshuar në pikën e kalimit kufitar dhe e regjistruar në modulën E-viza, konsultohet në sistem në të njëjtën mënyrë si vizat e lëshuara në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullorë jashtë shtetit.

4. Në rastet e anulimit dhe/ose bërjes së pavlefshme të vizës së lëshuar në kufi nga autoriteti përgjegjës në Ministrinë e Brendshme, pas kryerjes së procedurave të përshkruara në udhëzimin e përbashkët për bashkëpunimin mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt, informacioni mbi anulimin dhe/ose bërjen të pavlefshme të vizës hidhet menjëherë në regjistrin kombëtar të të huajve nga autoritetet i ngarkuar për lëshimin e vizës në kufi. Ky informacion konsultohet në sistem nga të gjitha strukturat e përcaktuara me këtë udhëzim.

V. MODULI I KONTROLLIT KUFITAR

PROCEDURA E REGJISTRIMIT NË SISTEM TË HYRJE-DALJEVE TË SHETASVE TË HUAJ NË PKK

1. Autoriteti kompetent për regjistrimin e hyrje-daljeve të të huajve në PKK (kontrollori i turnit), regjistron në hyrje dhe në dalje në PKK informacionin mbi të huajin që gjendet në dokumentin e tij të udhëtimit, ose gjeneralitetet e vetëdeklaruar nga i huaji për rastet e përcaktuara me ligj, në modulën e kontrollit kufitar (hyrje-daljet), të sistemit TIMS, sipas procedurave standarde të punës të miratuara për këtë qëllim.

2. Informacioni mbi të huajin, i hedhur nga kontrollori në PKK, në modulën e hyrje-daljeve, në mënyrë të automatizuar, konsultohet me të dhënat ekzistuese kufizuese në modulën e trajtimit të huajve, si dhe sipas procedurave të përcaktuara, me informacionin në modulet e tjera të regjistrimit.

3. Kontrollorët në PKK janë të detyruar të regjistrojnë të gjithë informacionin sipas rubrikave të përcaktuara në formë elektronike në modulën e kontrollit kufitar. Mosplotësimi i të gjitha rubrikave të këtij regjistri konsiderohet informacion i pamjaftueshëm për hyrje-daljen e shtetasit të huaj.

4. Me përfundimin e regjistrimit të saktë të të dhënave të të huajit dhe ruajtjes në sistem, këto të dhëna janë të pandryshueshme dhe mund të konsultohen *on line* nga të gjitha autoritetet e përmendura në kapitullin I, pika 2, të këtij udhëzimi.

5. Në rast se të huajt gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë jashtë afateve të lejuara të qëndrimit, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi apo në dokumentet e udhëtimit (vizës, lejes së qëndrimit), sistemi gjeneron një “alarm-alert” në formën e një liste, për t’u konstatuar dhe proceduar më tej nga autoritetet përgjegjëse për kontrollin e të huajve në territor.

6. Në rast se i huaji gjendet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kërkon të hyjë në Republikën e Shqipërisë, por afatet e lejuara për qëndrim janë tejkalluar, atëherë sistemi nuk mundëson regjistrimin e të huajit në hyrje, por atë të regjistrimit në modulën e trajtimit të të huajve dhe konkretisht të “refuzimit të hyrjes”.

7. Moduli hyrje-daljeve, si pjesë e regjistrimit kombëtar për të huajt gjeneron statistika sipas standardeve të sistemit Eurostat, si dhe raporte për periudha të caktuara kohore, të grupuara për nevojat e përdoruesit, sipas:

- a) emrit, mbiemrit;
- b) motivit të hyrjes;
- c) mjetit të transportit të përdorur;
- d) shtetësive;
- e) PKK;
- f) grupmoshave;
- g) tipit të dokumentit të përdorur.

VI. MODULI E-LEJE PUNË

PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË LEJEVE TË PUNËS NË SISTEM

1. Autoriteti shtetëror kompetent në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, që mbledh, administron dhe realizon përpunimin statistikor të lejeve të punës në nivel qendror është Drejtoria e Politikave Migratore, Kthimit dhe Riintegritimit.

2. Autoritetet përgjegjëse në nivel rajonal/vendor për lëshimin e lejeve të punës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, drejtoritë rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punës

dhe zyrat vendore të punësimit, pasi kryejnë procedurën e pranimit të kërkesës për pajisjen me leje pune, ripërtëritje apo përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune, hedhin informacionin mbi aplikimin në modulën E-leje pune të regjistrit elektronik kombëtar për të huajt.

3. Informacioni ekzistues në modulet e tjera të regjistrit kombëtar për të huajt, konsultohet në mënyrë të automatizuar me informacionin që hidhet në procedurën e aplikimit për leje pune apo përjashtimit nga detyrimi për pajisje me leje pune, duke mundësuar ose jo vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së lëshimit të lejes së punës.

4. Në rast se në momentin e aplikimit për leje pune, ndaj aplikuesit nuk ka informacion kufizues që pengon lëshimin apo ripërtëritjen e lejes së punës, personi përgjegjës që pranon aplikimin hedh gjithë informacionin në modul sipas rubrikave të përgatitura në formë elektronike dhe procedurave standarde të punës të miratuara për këtë qëllim. Mosplotësimi i të gjitha rubrikave konsiderohet informacion i pamjaftueshëm për pajisjen e aplikuesit për leje pune.

5. Me përfundimin e regjistrimit të saktë të aplikimit dhe ruajtjen në sistem, specialisti i pranimit pajis të huajin me leje pune provizore me afat njëmuajor, të cilën e gjeneron nga sistemi me një numër serial unik (të papërsëritshëm).

6. Në rast se pas pranimit të aplikimit dhe përfundimit të procedurave të verifikimit, merret një vendim në favor të pajisjes së kërkuesit me leje pune ose ripërtëritjen e saj, atëherë informacioni mbi lejen e punës së lëshuar hidhet në modul. Ky informacion është i pandryshueshëm dhe mund të konsultohet *on line* nga autoritetet e përmendura në pikën 2, kapitulli II, të këtij udhëzimi, si më poshtë:

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme:

- Postet konsullore në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit.

Në Ministrinë e Brendshme;

- Sektori i migracionit në Drejtorinë e Migracionit dhe Ripranimeve.

- Sektorët e migracionit në drejtoritë rajonale për kufirin dhe migracionin.

Në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

- Drejtoria e Politikave Migratore, Kthimit dhe Riintegrit;

- Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës;

- Drejtoritë rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës;

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit;

- Sektorët e migracionit dhe marrëdhënieve të punës në drejtoritë rajonale të punësimit;

- Zyrat vendore të punësimit.

7. Në rast se pas pranimit të aplikimit dhe përfundimit të procedurave të verifikimit, merret një vendim për refuzimin e pajisjes me leje pune të kërkuesit, atëherë informacioni mbi refuzimin e lejes së punës hidhet në modul. Ky informacion është i pandryshueshëm dhe konsultohet *on line* nga autoritetet e përmendura në pikën 2, kapitulli II, të këtij udhëzimi, si më poshtë:

Në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

- Drejtoria e Politikave Migratore, Kthimit dhe Riintegrit;

- Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës;

- Drejtoritë rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës;

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit;

- Sektorët e migracionit dhe marrëdhënieve të punës në drejtoritë rajonale të punësimit;

- Zyrat vendore të punësimit.

8. Në rast se pas pranimit të aplikimit, përfundimit të procedurave të verifikimit, refuzimit të pajisjes me leje pune të kërkuesit dhe hedhjes së informacionit mbi refuzimin e lejes së punës në modul, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, merret një vendim i dytë në favor të pajisjes me leje pune të kërkuesit, atëherë ky informacion mbi vendimin e marrë, si dhe informacioni mbi lejen e punës së lëshuar hidhet në modul. Ky informacion është i pandryshueshëm dhe mund të konsultohet *on line* nga autoritetet e përmendura në pikën 5 të këtij kapitulli.

9. Në rastet e anulimit dhe/ose bërjes së pavlefshme të lejes së punës së lëshuar, pas kryerjes së procedurave të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave për lejet e punës të sipërcituara, informacioni mbi vendimin për anulimin dhe bërjen të pavlefshme të lejes së punës hidhet menjëherë në regjistrin kombëtar për të huajt, modulën E-leje pune, nga autoritetet shtetërore

përgjegjëse sipas pikës 6 të këtij kapitulli. Ky informacion mund të konsultohen *on line* nga të gjithë autoritetet kompetente që konsultojnë të dhënat në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt të përmendura në pikën 2, kapitulli II, të këtij udhëzimi. Autoriteti i cili ekzekuton anulimin dhe bërjen e pavlefshme të lejes së punës, hedh gjithashtu në modulën E-leje pune informacionin me veprimet e kryera, informacioni i cili konsultohet nga të njëjtat autoritete si më sipër.

10. Pas përfundimit të afateve të lejes së punës, në rast se i huaji ndodhet në territor, sistemi konsulton në mënyrë të automatizuar të dhënat e lejes së punës dhe ato të regjistrimit të hyrje-daljeve dhe gjeneron një “alarm-alert” në formën e një raporti me shtetasit, të cilëve u ka përfunduar leja e punës, listë e cila konsultohet nga autoritetet përgjegjëse për ndjekjen e procedurave të përcaktuara në legjislacionin e punës.

11. Në rast se autoritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe drejtoritë rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës evidentojnë të huajt me punësim të paligjshëm, bëjnë shënimet përkatëse në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt, modulën E-leje pune, për sanksionet e vendosura mbështetur në legjislacionin në fuqi. Ky informacion konsultohet nga autoritetet sipas pikës 6 të këtij kapitulli.

12. Moduli E-leje pune, si pjesë e regjistrit kombëtar për të huajt, gjeneron raporte dhe statistika për afate të caktuara, sipas të dhënave që ka hedhur secila strukturë në këtë modul, si më poshtë:

Për Drejtorinë e Politikave Migratore, Kthimit dhe Riintegrimin:

Numrin e lejeve të punës, të ndara sipas:

- tipit,
- afatit,
- shtetësive,
- vendndodhjeve gjeografike në Shqipëri,
- autoriteteve lëshuese,
- grupmoshave,
- gjinive.

Numrin e kërkesave për leje pune të refuzuara, sipas:

- arsyes së refuzimit;
- autoritetit që ka bërë refuzimin;
- shtetësive të të refuzuarve;
- grupmoshave;
- gjinive.

Numrin e lejeve të punës të anuluar, sipas:

- tipit i lejes së punës së anuluar;
- shtetësive;
- grupmoshave;
- gjinive;
- autoritetit që ka lëshuar lejen e punës;
- motivin e anulimit.

13. Deri në shtrirjen e rrjetit në të gjitha zyrat vendore të punësimit, punonjësit e këtyre zyrave janë të detyruar që, brenda 5 ditëve, të dërgojnë pranë sektorit të migracionit dhe marrëdhënieve të punës në drejtoritë rajonale të punësimit aplikimet e pranuar, refuzimet e aplikimeve dhe miratimet e lejeve të lëshuara, si dhe të dhënat përkatëse. Punonjësit e sektorit të migracionit dhe marrëdhënieve të punës në drejtoritë rajonale të punësimit i hedhin të dhënat në regjistrin kombëtar sipas procedurave të përshkruara më lart.

VII. MODULI E-LEJE QËNDRIMI

PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË LEJEVE TË QËNDRIMIT NË SISTEM

1. Autoritetet përgjegjëse në nivel rajonal/vendor për lëshimin e lejeve të qëndrimit, pasi kryejnë procedurën e pranimit të kërkesës për pajisje me leje qëndrimi të të huajit, hedhin informacionin mbi aplikimin në E-leje qëndrimi të regjistrit elektronik kombëtar për të huajt.

2. Specialisti i pranimit në sektorin e migracionit të DRKM-së, për të regjistruar aplikimin në regjistrin e të huajve- moduli E-leje qëndrimi, gjeneron nga sistemi (regjistri elektronik për të

huajt) gjeneralitetet e sakta të kërkuesit të lejes së qëndrimit nëpërmjet të dhënave të dokumentit të udhëtimit me të cilin aplikanti ka hyrë në PKK dhe plotëson fushat e tjera me të dhëna nga aplikimi.

3. Në rast se në momentin e regjistrimit on line të aplikimit për leje qëndrimi, në bazën e të dhënave të njërit nga modulet e regjistrimit ekziston informacion me masa kufizuese për kërkuesin, sistemi, në mënyrë të automatizuar, nuk mundëson aplikimin për leje qëndrimi, por procedura vazhdon me hedhjen e informacionit në modulën e trajtimit të të huajve, konkretisht atë të refuzimit të pajisjes me leje qëndrimi dhe nxjerrjes së urdhrat të largimit.

4. Në rast se në momentin e regjistrimit *on line* të aplikimit për leje qëndrimi, informacioni me masa kufizuese për kërkuesin që ekziston në bazën e të dhënave të njërit nga modulet ka të bëjë me tejkalim të afateve të aplikimit për arsye që e justifikojnë moskryerjen e këtij veprimi dhe nga ana e autoriteteve të parashikuara me legjislacionin në fuqi është marrë një vendim për pranimin e aplikimit, atëherë sistemi mundëson aplikimin për leje qëndrimi.

5. Në rast se për kërkuesin për leje qëndrimi nuk ka informacion kufizues në modulet e regjistrimit, specialistët e migracionit në DRKM janë të detyruar të regjistrojnë të gjithë informacionin sipas rubrikave të përgatitura në formë elektronike në modulën e lejeve të qëndrimit dhe të përcaktuara me anë të rregullores së përdorimit të këtij moduli. Mosplotësimi i të gjitha rubrikave të këtij regjistri konsiderohet informacion i pamjaftueshëm për pajisjen e kërkuesit me leje qëndrimi.

6. Me përfundimin e regjistrimit të saktë të aplikimit dhe ruajtjen në sistem, specialisti i migracionit në DRKM, pajis të huajin me leje qëndrimi provizore me afat njëmuajor, të cilën e gjeneron nga sistemi me një numër serial unik (të papërsëritshëm). Të dhënat e aplikimit konsultohen *on line* në procedurën e verifikimit dhe miratimit në strukturat e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin të përcaktuara me aktet nënligjore në fuqi.

7. Në rast se gjatë procedurës së vlerësimit të aplikimeve për leje qëndrimi, shënimi i strukturave të Departamentit për Hetimin e Krimit dhe atij të Shërbimit Informativ Kombëtar në rubrikat përkatëse është në favor të lëshimit të lejes së qëndrimit, atëherë Drejtoria e Migracionit dhe Ripranimeve bën shënimin e gjykuar prej saj në rubrikën përkatëse në regjistër. Në rast se vendimi i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin është në favor të lëshimit të lejes së qëndrimit, atëherë ky vlen si autorizim për lëshimin e saj për DRKM që ka pranuar aplikimin dhe vetëm ky veprim në mënyrë të automatizuar i mundëson këtij autoriteti të vazhdojë procedurën për lëshimin e lejes së qëndrimit.

8. Në rast se njëra nga dy strukturat e përfshira në procedurën e vlerësimit të aplikimit për leje qëndrimi, bën shënimin në rubrikën përkatëse të regjistrimit se kërkon shtyrjen e afatit për vlerësimin e kërkesës, atëherë procedura e vlerësimit mbetet në mënyrë të automatizuar në pritje deri në 7 ditë të tjera.

9. Në rast se njëra nga dy strukturat e përfshira në procedurën e vlerësimit të aplikimit për leje qëndrimi, bën shënimin në rubrikën përkatëse të regjistrimit se kërkon rishtyrjen e afatit për vlerësimin e kërkesës, atëherë procedura e vlerësimit mbetet në mënyrë të automatizuar në pritje edhe deri në 7 ditë të tjera.

10. Në rast se asnjëra nga dy strukturat e përfshira në procedurën e vlerësimit të aplikimit për leje qëndrimi nuk kthen përgjigje brenda afatit të përcaktuar ose nuk bën shënimet në rubrikat përkatëse se kërkon shtyrjen e afatit apo rishtyrjen e afatit për vlerësimin e kërkesës për leje qëndrimi, ose kur dhe këto afate kanë kaluar dhe strukturat e sipërcituara nuk kanë kthyer përgjigje, kërkesa e konsideruar e miratuar mundëson që në mënyrë të automatizuar në sektorin e migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin të vazhdohet procedura e marrjes së vendimit për lëshimit ose refuzimin e lejes së qëndrimit.

11. Pas marrjes së vendimit për lëshimin ose refuzimin e lejes së qëndrimit nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, specialistit të sektorit të migracionit në DRKM i jepet e drejta të kryejë veprimet e tjera procedurale për pajisjen me leje qëndrimi të shtetasit të huaj dhe plotësimin e të dhënave mbi lejen e qëndrimit të lëshuar në regjistrin elektronik për të huajt. Pas vënies në përdorim të lejes biometrike për të huajt, specialisti i sektorit të migracionit në DRKM bën aktivizimin e lejes biometrike të qëndrimit dhe hedh në regjistër informacionin plotësues të lejes biometrike, sipas procedurave të miratuara.

12. Me lëshimin e lejes së qëndrimit nga DRKM, të dhënat e lejes së qëndrimit janë të pandryshueshme dhe konsultohen *on line* nga të gjitha autoritetet kompetente që konsultojnë të dhënat në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt të përmendura në pikën 2, kapitulli II, të këtij udhëzimi.

13. Në rastet e anulimit dhe/ose bërjes së pavlefshme të lejes së qëndrimit të lëshuar nga DRKM, pas kryerjes së procedurave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.2947/2, datë 6.10.2009 “Për bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e trajtimit të të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë”, informacioni mbi anulimin dhe bërjen të pavlefshme të lejes së qëndrimit hidhet menjëherë në regjistrin kombëtar për të huajt nga autoriteti shtetëror përgjegjës në DRKM. Ky informacion konsultohet *on line* nga të gjithë autoritetet kompetente që konsultojnë të dhënat në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt të përmendura në pikën 2, kapitulli II, të këtij udhëzimi.

14. Në rast se pas ankimeve mbi refuzimin e pajisjes me leje qëndrimi ose anulimit të lejes së qëndrimit merret një vendim në favor të huajit që ka bërë ankimin, atëherë informacioni mbi vendimin e marrë hidhet në regjistër, gjithashtu sistemi mundëson vazhdimin e procedurës për pajisje me leje qëndrimi për rastet e refuzimit, si dhe bën të vlefshme lejen e qëndrimit të anuluar.

15. Pas përfundimit të afatit të lejes së qëndrimit lëshuar shtetasve të huaj, nëse i huaji ndodhet në territor, sistemi, duke u konsultuar në mënyrë të automatizuar me të dhënat në modulën e lejeve të qëndrimit, si dhe atë të hyrje-daljeve të modulit të kontrollit kufitar, gjeneron një “alarm alert” në formën e një raporti me shtetasit të cilëve u ka përfunduar leja e qëndrimit dhe nuk kanë aplikuar për ripajisje me leje, listë e cila konsultohet nga autoritetet e Policisë Kufitare dhe Migracionit të ngarkuara me kontrollin e të huajve në territor dhe të përmendura në këtë udhëzim.

16. Moduli E-leje qëndrimi, si pjesë e regjistrit kombëtar të të huajve, gjeneron statistika dhe raporte për afate të përcaktuara, sipas të dhënave të hedhura në këtë modul, sipas:

Numrin e lejeve të qëndrimit të lëshuara, ndarë sipas:

- tipit,
- motivit,
- afatit,
- shtetësive,
- autoriteteve lëshuese,
- grupmoshave,
- gjinive.

Numrin e kërkesave për leje qëndrimi të refuzuara:

Nga DRKM:

- arsyes së refuzimit;
- drejtoria që ka bërë refuzimin;
- shtetësive të të refuzuarve;
- grupmoshave;
- gjinive.

Nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, sipas:

- arsyes së refuzimit;
- strukturës që ka propozuar refuzimin;
- shtetësisë së të refuzuarve;
- grupmoshave;
- gjinive.

Numrin e lejeve të qëndrimit të anuluar, sipas:

- motivit;
- shtetësive;
- grupmoshave;
- gjinive;
- autoritetit që ka lëshuar lejen e qëndrimit;
- vendit ku është bërë anulimi i lejes;
- tipit të lejes se qëndrimit të anuluar;

- autoriteti që ekzekuton anulimin e lejes.

VIII. MODULI I TRAJTIMIT TË TË HUAJVE NË TERRITOR

PROCEDURA E REGJISTRIMIT NË SISTEM E TË HUAJVE TË PËRZGJEDHUR SI TË PARREGULLT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Autoriteti i Policisë Kufitare dhe Migracionit administrojnë të dhënat mbi përzgjedhjen dhe kufizimet e të huajve të parregullt në territorin e Shqipërisë, i regjistron këto të dhëna në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt, në modulën e trajtimit të të huajve të parregullt në kufi dhe në territor.

2. Punonjësit në sektorin e migracionit të DRKM ose PKK, pas përzgjedhjes ose evidentimit të një të huaji të parregullt, kryejnë procedurat sipas ligjit “Për të huajt”, udhëzimit të përbashkët nr.2947/2, datë 6.10.2009 dhe hedhin informacionin sipas rubrikave të përgatitura në formë elektronike në modulën e trajtimit të të huajve të parregullt në territor, sipas rregullores së përdorimit të këtij moduli. Mosplotësimi i të gjitha rubrikave të formës elektronike konsiderohet informacion i pamjaftueshëm për ruajtjen e informacionit në sistem.

3. Në rastet kur gjatë procedurës së përzgjedhjes së shtetasve të parregullt, është i mundur përcaktimi i identitetit të tyre, autoriteti rajonal për kufirin dhe migracionin i ngarkuar për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së të huajve të parregullt, mbush rubrikat përkatëse të modulit të përzgjedhjes së shtetasve të huaj në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt, me gjeneralitetet e të huajt, sipas statusit të përcaktuar:

- a) azilkërkuar;
- b) viktimë trafiku;
- c) viktimë e mundshme trafiku;
- d) imigrant i parregullt.

4. Informacioni i regjistruar në modul për çdo status të lartpërmendur konsultohet përveç strukturës që ka hedhur informacionin dhe nga strukturat përkatëse:

a) Azilkërkuar - Drejtoria për Shtetësi dhe Refugjatë në Ministrinë e Brendshme;

b) Viktimë trafiku, viktimë e mundshme trafiku - struktura për viktimat e trafikut të përcaktuara në mekanizmin kombëtar të referimit.

c) Imigrant i parregullt – Qendra e Mbyllur në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin.

5. Secila nga strukturat në pikën 4 të këtij kapitulli, konsulton informacionin e regjistruar, kryejnë procedurat përkatëse bazuar në legjislacionin në fuqi dhe plotëson të dhënat në vijim, sipas rubrikave të përgatitura në formë elektronike në modulën e trajtimit të të huajve të parregullt në territor dhe rregullores së përdorimit të këtij moduli. Mosplotësimi i të gjitha rubrikave të formës elektronike konsiderohet informacion i pamjaftueshëm për ruajtjen e informacionit në sistem.

6. Nëse i huaji evidentohet si azilkërkuar, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, pas kryerjes së procedurave dhe marrjes së vendimit në favor ose kundër pajisjes së të huajt me statusin përkatës, hedh informacionin në modulën e trajtimit të të huajve të parregullt në territor, në regjistrin elektronik për të huajt.

7. Informacioni mbi rastet e trajtimit të të huajve të parregullt në territor përbëhet nga:

a) Urdhrat e ndryshëm (largim/largim me forcë/dëbim/ndalim në Qendrën e Mbyllur/qëndrim i detyrueshëm në një territor të caktuar)-sipas rubrikave të përcaktuara në formë elektronike përkatëse të këtij moduli në regjistrin.

b) Informacionin mbi ripranimet e shtetasve të huaj (shtetasit e palëve kontraktuese dhe shtetasit e vendeve të treta, si dhe personave pa shtetësi).

c) Informacioni mbi refuzimin e hyrjes sipas rasteve të përshkuara në ligjin “Për të huajt” si dhe në PKM nr.362, datë 1.4.2009.

d) Informacion mbi masat administrative të vendosura të huajve.

e) Informacion mbi masat kufizuese të vendosura nga organizmat ndërkombëtarë ku Shqipëria bën pjesë, si dhe masave kufizuese në:

http://ec.europa.eu/external_relations/cfsp/sanctions/measures.htm

6. Autoriteti qendror konsullor i Ministrisë së Punëve të Jashtme ka përgjegjësinë të hedhë të dhënat sipas kërkesave të listave të publikuara në website-in e sanksioneve në fjalë, ndërsa strukturat e tjera të posteve konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, shërbimet e Policisë

Kufitare të Migracionit, përfshirë të gjitha pikat e kalimit kufitar të Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimit Informativ Shtetëror kanë akses të konsultojnë këto lista. Gjithashtu, Shërbimi Informativ Shtetëror mund të hedhë në këtë modul informacion me masa kufizuese mbi të huajt (ndalim hyrjeje apo njoftim në kufi) sipas kërkesave dhe nevojave të punës së tyre.

7. Pas ruajtjes së informacionit në sistem nga të gjitha strukturat përgjegjëse të lartpërmendura, të dhënat e regjistruara janë të pandryshueshme dhe konsultohen *on line* nga të gjitha autoritetet kompetente që konsultojnë të dhënat në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt të përmendura në pikën 2, kapitulli II, të këtij udhëzimi.

8. Moduli i trajtimit të të huajve të parregullt në PKK dhe territor, si pjesë e regjistrit elektronik kombëtar të të huajve, gjeneron raporte dhe statistika për afate të caktuara kohore sipas të dhënave që ka hedhur secila strukturë, si vijon:

1. Numri i urdhrave të lëshuara, ndarë sipas:

- llojit të urdhrimit,
- arsyes,
- afatit,
- shtetësive,
- autoriteteve lëshuese të urdhrimit,
- grupmoshave,
- gjinisë.

2. Numri i personave të ripranuar, ndarë sipas:

- shtetësisë së të ripranuarve;
- shtetit që i kthen;
- strukturës pritëse (PKK);
- mënyrës së kthimit;
- grupmoshave;
- gjinive.

3. Numri i refuzimit të hyrjeve, ndarë sipas:

- arsyes së refuzimit;
- strukturës që ka propozuar refuzimin;
- shtetësisë së të refuzuarve;
- grupmoshave.

4. Numri i masave administrative, ndarë sipas:

- arsyes së masës së dhënë;
- strukturës që e ka dhënë;
- shtetësisë;
- grupmoshës.

5. Numri i personave të përzgjedhur, ndarë sipas:

- statusit,
- shtetësive,
- autoriteteve që kryejnë procedurën,
- grupmoshave,
- gjinisë.

6. Numri i personave azilkërkues, ndarë sipas:

- shtetësisë;
- motivit;
- akomodimit;
- grupmoshave;
- gjinisë.
- vendit ku kanë kërkuar azil (në kufi, territor, përfaqësitë tona diplomatike jashtë Shqipërisë);
- vendit të fundit nga kanë ardhur;

7. Numri i personave në Qendrën e Mbyllur, ndarë sipas:

- autoritetit urdhërues,
- shtetësisë,
- afateve të qëndrimit,
- motivit,
- grupmoshave
- gjinisë.

8. Numri i personave në Qendrën e Viktimave të Trafikut, ndarë sipas:

- shtetësisë,
- afateve,
- grupmoshave,
- gjinisë.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi strukturat përgjegjëse të përcaktuara me këtë udhëzim në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimin Informativ të Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE
MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Illir Meta

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE
SOCIALE DHE SHANSEVE TË
BARABARTA
Spiro Ksera

DREJTORI I SHËRBIMIT INFORMATIV
TË SHTETIT
Bahri Shaqiri

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 1.3.2010

Doli nga shtypi më 1.3.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 20 lekë